



# RELACIONI TEKNIK

Rikonstruksioni i shkolles 9-vjeçare  
‘Fadil Gurmani’


Relacioni Teknik i Projektit Hidrosanitar

**Prill, 2023**

## RELACION HIDROSANITAR

Shkolla "Fadil Gurmani" ndodhet ne Lagjen "Haxhias", ne rrugen Ismail Zyma ne veri te qytetit te Elbasanit. Shkolla eshte 2 kate dhe eshte ndertuar me konstruksion tulle me soleta SP dhe siper eshte e mbuluar me solete.

Zona Kadastrale 8525 , Pasuria nr. 5.103.



### **PËRSHKRIMI I GJENDJES EKZISTUESE**

Shkolla "Fadil Gurmani" ndodhet ne Lagjen "Haxhias" ne veri te qytetit te Elbasanit ne lindje te godines se Universitetit "Aleksander Xhuvani". Hyrja kryesore e shkollës është ne anen jugore ne rrugen "Ismail Zyma". Rikonstruksioni i shkollës është bere ne vitin 1996. Shkolla është 2 kate dhe është ndertuar me konstruksion tulle me soleta SP dhe siper është e mbuluar me solete.

Ambientet e brendshme të objektit janë tejet të amortizuara dhe nuk përmbushin asnjë standart për zhvillimin e programit mësimor. Nyjet higjenosanitare nuk janë ne gjendje te mire, mungojne kasetat e shkarkimit, paisjet sanitare janë te demtuara te cilat do te rikonstruktohen sipas kushteve teknike me materiale bashkekohore duke i pershtatur sipas projektit te paraqitur. Tualete do te nivelohen ne kuoten e soletes, do te hidroizolohen totalisht, do te montohen instalimet e reja hidrosanitare, do te mbushen me penobeton per shtrese e mbushjes 7-10 cm dhe do te kryhet h/izolimi i plote per te mos patur lageshtire ne tualete. Mbi kete shtrese do te shtrohen me pllaka gres porcelanate te ratifikuar dhe pjesa e lavamaneve do te jete me mermer, lavamane inkaso dhe wc allaturka. Ne secilin kat te godines si ne katin perdhe ashtu edhe ne katin e pare ndodhen perkatesisht nga dy tuatele si per meshkujt ashtu edhe per femrat, ne total 4 tualete. Dyert do te jene duro alumini dopio xham sipas projektit të paraqitur, ne secilen nyje sanitare te objektit është parashikuar montimi tre wc allaturka dhe dy lavamane inkaso sipas projektit per secilin tualet.

## QËLLIMI I PROJEKTIT

Nisur nga projekti arkitektonik është dhënë zgjidhja e plotë për funksionimin normal të ambienteve të shkollës, duke realizuar një projekt për rikonstruksionin e shkollës i cili duhet të përmbushë standartet bashkohore për zhvillimin e orës mësimore si nga ana e organizimit funksional të ambienteve të brendshme por edhe nga ana e organizimit të hapësirave të jashtme por edhe nga ana e cilësisë materiale të përdorura në objekt. Ambientet e tualetit duhet të jenë konform standarteve të projektimit të parashikuara. Për këtë arsye është parashikuar që linjat kryesore të furnizimit do të jenë ato ekzistuese si dhe linjat e shkarkimit do të jenë të njëjta. Është parashikuar edhe një sistem drenazhi i cili do të kryhet me tuba të brinjëzuar HDPE SN8 d=315 mm duke shkarkuar në linjen kryesore në kater puseta kontrolli që do të shkarkojnë me një tub të brinjëzuar drenazhi HDPE d=315 mm në puseten e ujërave të zeza, që plotësojnë të gjitha kushtet teknike dhe kërkesat e projektit. Para përfundimit të punimeve duhet parashikuar që tubacioni për ujrat e zeza të pastrohen dhe të riparohen në ato segmente që do të futen në punë. Të pozicionohen dhe të fiksohen që të mos demtohen gjatë punimeve.

**Punoi: Ing. Bruno Korumi**

*Dr. DP-se:*  
*ark. Marvis Avllazagaj*

**MIRATOI**

**KRYETARI BASHKISË**

**GLEDIAN LLATJA**

